



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 22.06.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 17.06.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik NPN EUROING SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i objektit të banimit social - Kontratë dy vjeçare “, **Nr. i prokurimit- 632-22-5053-5-2-1, nxjerr:**

V E N D I M

- 1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: NPN EUROING SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i objektit të banimit social - Kontratë dy vjeçare “, **Nr. i prokurimit- 632-22-5053-5-2-1** kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë të AK –së, të datës 18.05.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.**
- 2. Përmirësohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË , i publikuar me datë: 02.06.2022;**
- 3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë përmirësimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.**
- 4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .**

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik NPN EUROING SH.P.K., ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit ““Ndërtimi i objektit të banimit social - Kontratë dy vjeçare “ , Nr. i prokurimit- 632-22-5053-5-2-1,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 22.06.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit të Kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik NPN EUROING SH.P.K., të dt.17.06.2022, Autoriteti kontraktues, konstaton se pretendimet e Operatorit në fjalë, janë pjesërisht të bazuara, prandaj vendos që të bëj përmirësimin e dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

z.Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

